



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**RREGULLORE**

**MBI LLOGARITJEN E MBAJTJES NETO TË MBULIMIT MAKSIMAL AGREGAT TË  
RREZIQEVE QË RRJEDHIN NGA KONTRATAT E SIGURIMIT**

*Miraturar me vendimin e Bordit nr. 57, datë 26.05.2017*

**Neni 1**  
**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregulla për shoqëritë e sigurimit në lidhje me llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, nga tërmetet dhe rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar për kontratat e nënshkruara nga shoqëria e sigurimit.

**Neni 2**  
**Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 116, pikat 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Periudhë Kthimi: Për një ngjarje (tërmet) me periudhë kthimi n-vite nënkupton ngjarjen që ka  $1/n$  probabilitet të ndodhë në një vit.<sup>1</sup>

Dëm Maksimal i Mundshëm Bruto (DMM) i një portofoli të caktuar për një Periudhë Kthimi të caktuar (n-vite): Është vlera përtej të cilës nuk pritet të ketë dëme të shkaktuara nga një ngjarje (tërmet) e vlerësuar me periudhë kthimi n-vite që llogariten duke marrë parasysh pjesën e zbritshme të shprehur në përqindje të vlerës së portofolit.

---

<sup>1</sup> Periudha e kthimit për një ngjarje i korrespondon reciprokisht probabilitetit të ngjarjes për të ndodhur. Shembull: Një ngjarje me periudhë kthimi 60 vjet nënkupton një probabilitet vjetor 1.66% të ndodhjes së një tërmeti me parametra të caktuar.

Pjesë e Zbritshme: Është pjesa e vlerës së portofolit që duhet të arrihet para se dëmi të paguhet nga siguruesi në tejkalim të kësaj vlere.

Dëmi Standard për një portofol të siguruar: Është dëmi maksimal i mundshëm bruto për periudhën e kthimit të përcaktuar në këtë rregullore.

Sigurimi nga Tërmeti: Nënkupton kontratat e sigurimit nga tërmeti për dëmet e lidhura me dëmtimin fizik të ndërtesave dhe pajisjeve të vendosura në to.

Mbajtja Agregate Neto: Nënkupton mbajtjen neto të mbulimit maksimal agregat të rrezeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të tërmeteve sipas përcaktimit të nenit 116, pika 5 dhe 6 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Kapaciteti i vetë shoqërisë për Sigurimin nga Tërmeti: Është diferenca midis aftësisë paguese me nivelin minimal të aftësisë paguese të shoqërisë.

Metodologji Standarde: Është metodologjia e përcaktuar në këtë rregullore për të llogaritur Mbajtjen Agregate Neto.

Ngarkesa e rrezikut të Kreditit të Risiguruesit: Është shuma e llogaritur në lidhje me rrezikun financiar të mospërbushjes të detyrimit kontraktual nga risiguruesi.

Depozitë Minimale e Primit: Është shuma fikse e përcaktuar paraprakisht për primin vjetor të marrëveshjes jo proporcionale të risigurimit, që rregullohet mbi baza vjetore bazuar në vëllimin e shkruar të biznesit të matur nëpërmjet primeve ose ekspozimit.

#### **Neni 4**

#### **Metodologjia standarde e llogaritjes së Mbajtjes Agregate Neto**

Shoqëria e sigurimit duhet të llogarisë Mbajtjen Agregate Neto, sipas Metodologjisë Standarde të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje për ekspozimin nga të gjitha kontratat e Sigurimit nga Tërmeti si diferenca midis (i) Dëmit Standard dhe (ii) Pjesës së Risiguruar të Dëmit Standard.

#### **Neni 5**

#### **Llogaritja e Dëmit Standard**

Dëmi Standard për një portofol kontratash sigurimi nga tërmeti llogaritet si prodhim i totalit të shumave të siguruara të këtyre kontratave me Faktorin Standard<sup>2</sup> të përcaktuar në vlerën 1,74% në shkallë vendi.

---

<sup>2</sup> Faktori Standard është përcaktuar si raport i (i) Dëmit Maksimal të Mundshëm Bruto (DMM) me Pjesë të Zbritshme 3% të llogaritur mbi ekspozimin e të gjithë stokut të ndërtesave dhe pajisjeve përkatëse në Shqipëri, sipas Modelit të Rrezikut të Tërmetit për Periudhë Kthimi 60 vjet me (ii) vlerën totale të këtij stoku. Në funksion të përafrimit gradual me standardet Evropiane, Autoriteti mund të rishikojë Faktorin Standard dhe të përfshijë faktorë të tjerë (që mund të konsiderohen në

Formula (1): Llogaritja e Dëmit Standard

$$\text{Dëmi Standard (DS)} = F_v \times \sum_i SI_i$$

ku:

$F_v$  është Faktori Standard në shkallë vendi.

$\sum_i SI_i$  është totali i shumave të siguruara nga tërmeti për grupin e kontratave në fuqi në datën e llogaritjes, të zhveshura nga shumat që u korrespondojnë pjesëve të siguruara nga shoqëri të tjera nëpërmjet bashkësigurimit.

### Neni 6

#### Llogaritja e pjesës së risiguruar të Dëmit Standard

1. Pjesa e risiguruar e Dëmit Standard llogaritet si shumë e pjesëve të risiguruara nga çdo marrëveshje dhe kontratë fakultative risigurimi që mbulon rrezikun e Sigurimit nga Tërmeti.

Formula (2): Pjesa e risiguruar e Dëmit Standard Bruto

$$(2) \text{Pjesa e risiguruar e DS} = \sum_i \text{Pjesën e risiguruar të DS nga risigurimi } i$$

2. Llogaritja e pjesës së risiguruar të Dëmit Standard sipas çdo marrëveshjeje apo kontrate fakultative risigurimi, duhet të marrë parasysh kushtet dhe termat e risigurimit në lidhje me risigurimin e rrezikut të tërmetit, përqindjen e risiguruar në rast se risigurimi nuk është vendosur në masën 100% sipas kontratës, si edhe rendin e zbatimit të marrëveshjeve apo kontratave të ndryshme të risigurimit që mund të zbatohen mbi të njëjtin ekspozim.
3. Në aneksin bashkangjitur kësaj rregulloreje bëhet një përmbledhje e llogaritjes për dy llojet e marrëveshjeve të risigurimit më të përdorura në praktikë.
4. Pjesa e risiguruar e Dëmit Standard sipas risigurimit fakultativ llogaritet në mënyrë të ngjashme me marrëveshjet e risigurimit.

### Neni 7

#### Llogaritja e Mbajtjes Agregate Neto

Mbajtja Agregate Neto llogaritet si diferencë e Dëmit Standard të llogaritur për të gjitha kontratat e sigurimit me Pjesën e Risiguruar.

Formula (3): Llogaritja e Mbajtjes Agregate Neto

---

për llogaritjen e dëmit standard janë: ndarja e ekspozimit bazuar në prefektura; llogaritja e ngarkesës së rrezikut të kreditit të risiguruesit) për llogaritjen e Dëmit Standard.

(3)

**Mbajtja Agregate Neto =**

**$DS_{\text{për të gjithë kontratat}}$  – Pjesën e Risiguruar të DS nga të gjithë risigurimet e zbatueshme**

ku llogaritjet e Dëmit Standard dhe Pjesës së risiguruar përshkruhen përkatësisht në nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 8**

### **Kërkesa rregullatore për Mbajtjen Agregate Neto**

1. Mbajtja neto e mbulimit maksimal agregat të rreziqeve të shoqërisë së sigurimit prej Sigurimit nga Tërmeti (Mbajtja Agregate Neto), nuk tejkalon Kapacitetin e vetë shoqërisë për Sigurimin nga Tërmeti.
2. Norma e Mbajtjes Agregate Neto për Sigurimin nga Tërmeti (NST) e llogaritur si raport i Kapacitetit të vetë shoqërisë për Sigurimin nga Tërmeti me Mbajtjen Agregate Neto nuk duhet të jetë më e vogël se 1 (një). Shoqëria e sigurimit rekomandohet të mbajë në monitorim Mbajtjen Agregate Neto në rast se Norma NST bie nën nivelin 150% dhe të marrë masa për të rritur Normën NST nëse është më e ulët se 120%.

Formula (6): Norma e Mbajtjes Agregate Neto për Sigurimin nga Tërmeti (NST)

$$(6) \text{ NST} = \frac{\text{Kapaciteti i Sigurimit nga Tërmeti}}{\text{Mbajtja Agregate Neto}}$$

## **Neni 9**

### **Raportimi në Autoritet**

1. Shoqëria e sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i gjashtë mujorit dhe vitit financiar raporton në Autoritet Mbajtjen Agregate Neto dhe Normën e Mbajtjes Agregate Neto të llogaritura në përputhje me këtë rregullore, së bashku me të dhënat dhe llogaritjet përkatëse nga Aktuari i Autorizuar.
2. Në rast se Norma e Mbajtjes Agregate Neto është nën kufirin e lejuar, Autoriteti i kërkon shoqërisë së sigurimit të marrë masa për mbajtjen në kontroll të ekspozimit prej Sigurimit nga Tërmeti dhe sjelljen e normës në vlera të lejuara.

## **Neni 10**

### **Mbajtja Agregate Neto nga rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar për kontratat e nënshkruara nga shoqëria e sigurimit.**

1. Shoqëria e sigurimit harton rregulla të brendshme në lidhje me administrimin e akumulimit të rrezikut të lidhur me rreziqe të tjera agregate<sup>3</sup> që merren në sigurim nga shoqëria dhe i vë ato në dispozicion të Autoritetit me kërkesë të këtij të fundit.

---

<sup>3</sup> Të quajtura ndryshe edhe rreziqe katastrofike, ku përveç tërmetejeve përfshihen edhe përmytja, rrëshqitja, stuhia, etj.

2. Shoqëria e sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i gjashtë mujorit dhe vitit financiar raporton në Autoritet shumat agregate të rreziqeve të sigurimit të pronës nga përmbytja në nivel prefekturë dhe marrëveshjet e risigurimit që mbulojnë këto rreziqe.

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datë 1 janar 2019.
2. Pavarësisht pikës 1) të këtij neni, shoqëritë e sigurimit do të raportojnë në Autoritet Mbjtjen Agregate Neto dhe Normën e Mbjtjes Agregate Neto siç paraqitet në 31 dhjetor 2017 mbi baza ushtrimore.

## ANEKSI

### Llogaritja e dëmit standard

Më poshtë bëhet një përmbledhje e llogaritjes për dy llojet e marrëveshjeve të risigurimit më të përdorura në praktikë:

Skenari 1: Marrëveshja proporcionale e zbatuar drejtpërdrejt mbi portofolin e siguruar (para çdo marrëveshjeje tjetër)

- a) Pjesa e risiguar e Dëmit Standard sipas risigurimit proporcional llogaritet si prodhim i përqindjes së kaluar në risigurim të Dëmit Standard të llogaritur për kontratat mbi të cilat zbatohet marrëveshja e risigurimit.
- b) Pjesa e risiguar e Dëmit Standard (DS) sipas risigurimit proporcional nuk mund të jetë më e madhe së kufiri i mbulimit për ngjarje (apo kufiri vjetor i mbulimit, nëse nuk zbatohet kufiri i mbulimit për ngjarje) në rast se zbatohet sipas marrëveshjes së risigurimit.

Formula (2.1): Zbatimi i marrëveshjes proporcionale të risigurimit

$$(2.1) \text{ Pjesa e risiguar në mënyrë proporcionale} \\ = \text{Min} (Y, X\% \times \text{DS}_{\text{për kontratat mbi cilat zbatohet marrëveshja}})$$

ku,

**X %** - Është përqindja e Dëmit Standard të kaluar në risigurim nëpërmjet marrëveshjes proporcionale.

**Y** - Është kufiri i mbulimit që mbulon marrëveshja për një ngjarje, apo mbi baza vjetore në rast se shuma maksimale nuk përcaktohet për ngjarje. Në rast se marrëveshja nuk përcakton kufi mbulimi për ngjarje apo mbi baza vjetore, Y merret e barabarte me Dëmin Standard.

**DS** për kontratat mbi të cilat zbatohet marrëveshja - llogaritet sipas Formulës (1) për totalin e shumave të siguruara mbi të cilat zbatohet marrëveshja.

Skenari 2: Marrëveshja jo proporcionale e risigurimit (e tipit tejkalim i humbjes) e zbatuar drejtpërdrejt mbi portofole të sigurimit (para çdo marrëveshjeje tjetër)

- a) Pjesa e risiguar e Dëmit Standard sipas risigurimit të tipit tejkalim i humbjes llogaritet si diferencë e (i) Dëmit Standard të llogaritur për kontratat mbi të cilat zbatohet marrëveshja e risigurimit me (ii) Prioritetin e shoqërisë për një ngjarje siguri dhe nuk kalon kufirin e mbulimit në risigurim (në tejkalim të Prioritetit) për të gjithë shtresat e marrëveshjes. Në rast se diferenca midis Dëmit Standard dhe Prioritetit është negative, pjesa e rrezikut të risiguar do të merret 0 (zero).

Formula (2.2): Zbatimi i marrëveshjes së tipit tejkalim i humbjes e zbatuar drejtpërdrejt mbi portofolin e sigurimit (para çdo marrëveshjeje tjetër)

(Shembull i thjeshtuar për marrëveshje me një shtresë të vendosur 100% në risigurim. Qasja dhe llogaritjet janë të ngjashme për marrëveshjet me disa shtresa).

**(2.2) Pjesa e risiguruar me marrëveshje TH**

$$= \text{Min} \{ \text{Kufiri}, \text{Max} [0, (\text{DS}_{\text{për kontratat mbi të cilat zbatohet marrëveshja}} - \text{Prioriteti})] \}$$

Ku:

**Prioriteti** - Është maksimumi i mbajtur nga shoqëria e sigurimit për dëmin nga një ngjarje para se të fillojë detyrimi i marrëveshjes.

**Kufiri** - Është shuma maksimale e pagueshme nga shoqëria e risigurimit për një Ngjarje Sigurimi.

**DS<sub>për kontratat mbi të cilat zbatohet marrëveshja</sub>** - llogaritet sipas Formulës (1) për shumat e siguruara mbi të cilat zbatohet marrëveshja.